



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1471 Prot

Tiranë më 20.3.2020

URDHËR

Nr. 5, datë 20.03.2020

“Për zhvillimin e procesit mësimor në platformat online me studentët e Universitetit të Tiranës”

Bazuar në nenin 39 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 34 të Statutit të Universitetit të Tiranës; në pikën 4 të Urdhërit nr.156 datë 10.03.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, si dhe në kërkesat dhe porositë e përcjella nëpërmjet email-it nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në cilësinë e Rektorit të Universitetit të Tiranës:

URDHËROJ:

1. Zhvillimin e procesit mësimor në platformat online me studentët e Universitetit të Tiranës, sipas vlerësimeve të njëjësive kryesore të UT, por gjithmonë duke ruajtur standardet bazë të procesit të mësimdhënies.
2. Njësitë kryesore, pasi të kenë analizuar dhe vlerësuar platformat më të mundshme që mund të operohen në bazë departamenti/fakulteti ose edhe universiteti, të bëjnë testimin dhe pilotimin e leksioneve online sa më parë.
3. Njësitë kryesore, pasi të kenë bërë testimin dhe pilotimin e leksioneve online, të depozitojnë përmes komunikimit elektronik informacion për platformat online që do të përdorin për zhvillimin e procesit mësimor, **brenda datës 27 mars 2020, në adresën info@unitir.edu.al.**
4. Ngarkohen zv/Rektori për anën kërkimore-shkencore, Administratori i UT, njësitë kryesore të Universitetit të Tiranës për zbatimin e këtij Urdhëri.
5. Ky Urdhër ka karakter të përkohshëm dhe do të zbatohet për atë kohë sa zgjat periudha e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

